



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.669/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković – Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Eing Com”sh.p.k- Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “Parajsa shpk & NNP Emsa”- Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, më datën: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Eing Com”sh.p.k- Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, dhe lënda kthehet ne **Rivleresim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” sh.p.k- Podujevë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, të njëjtit operator ekonomik i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Eing Com” sh.p.k- Podujevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.09.2020 me nr. 669/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59, 65, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt. 28.09.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontratë në pozicionet 1.3, 3.1, 5.4, 6.1, 8.1, ka ofruar çmime të cilat sipas OE ankues janë çmime Jo/Normalisht te ulëta, eksperti shqyrtues vlerëson se sipas nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues, në rastin konkret AK-ja, nuk e ka vlerësuar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta. Prandaj, ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se AK-ja, sipas procedurave të parapara në nenin 61 të LPP-së, i ka kërkuar sqarime për pozicionet e ofruara dhe për të njëjtat përgjigje OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar përgjigje.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me autorizimet e dorëzuara nga i rekomanduari për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se konform sqarimeve të dhëna në raportin e parë të ekspertizës dhe vendimit të

PSH-së nr. 454/20, autoriteti kontraktues ka vepruar konform nenit 72 të LPP-së, ku është sqaruar me operatorin ekonomik, i cili në përgjigje ka deklaruar se furnizimet do të bëhen nga prodhuesi AVA Park, ndërsa autorizimi tjetër i vendosur në ofertë aksidentalisht është vendosur edhe një autorizim tjetër.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në përputhje të plot me dispozitat e nenit 59 ka bërë vlerësimin e ofertave dhe njëherit ka respektuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës – çmimi më i ulët.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues me datë 28.09.2020, me të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 29.09.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, sepse eksperti nuk e ka shtjelluar ankesën tonë kësaj radhe fare duke aluduar se pikat e ankesës janë të njëjta sikurse në ekspertizën e herës së 1-rë por edhe pretendimet ankimore të parashtruara nga ana jonë nuk janë shtjelluar sipas pretendimeve tona.

Pretendimi 1: OE ka ofruar çmime jo-normalisht të ulët në disa pozicione –Eksperti shqyrtues nuk e ka shtjelluar në tërësi pretendimin tonë (detajisht e cekur në ankesë).

Pretendimi 2: OE ka ofruar dy (2) autorizime nga dy prodhues e që është në kundërshtim me kërkesën e AK, ku në FTD ceket që variantet nuk autorizohen.

Eksperti shqyrtues e len të hapur mundësinë e AK-së të përcaktohet në njërin variant.

Pretendimi 3: OE nuk ka ofruar katalogë me përshkrim detal për produktet sipas kërkesës se AK-së, eksperti nuk e ka shtjelluar fare këtë pretendim.

Nga të gjitha këto arsye time kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues që të na jepet mundësia e prezantimit të fakteve dhe dëshmive me përfaqësim në seancë dhe se ankesën tonë ta vlerësoj si të bazuar dhe lëndën ta kthej në Ri-vlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave,

raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eing Com” sh.p.k- Podujevë, se i rekomanduari për kontratë në pozicionet 1.3, 3.1, 5.4, 6.1, 8.1, ka ofruar çmime të cilat sipas OE ankues janë çmime Jo/Normalisht të ulëta. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues, në rastin konkret AK-ja nuk e ka vlerësuar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta. Prandaj, ky pretendim është i pa bazuar për faktin se AK sipas procedurave të parapara në nenin 61 të LPP-së i ka kërkuar sqarime për pozicionet e ofruara dhe për të njëjtat përgjigje OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar përgjigje.

Lidhur me pretendimin OE ankues “Eing Com” sh.p.k- Podujevë që ka të bëjë me autorizimet e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy variante të autorizimeve në kundërshtim me piken 4.1 të FDT-së, ku AK nuk ka lejuar variante, por edhe pas vendimit të OSHP-se 454/20, AK ka kërkuar sqarime shtese, ndërsa OE në përgjigjen të cilën e ka ofruar thuhet se furnizimi do të bëhet nga Prodhuesi AVP Park ndërsa autorizimi tjetër i Kompanisë FALGEO është dorëzuar aksidentalisht, ndërsa tek autorizimi FALGEO ceket se është autorizuar për projektin me titull “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, andaj kjo dëshmon qartë se nuk ka dorëzuar aksidentalisht dokumentin në fjalë. Por me këtë është lajthit AK pasi që OE ka ofertuar me dy variante të ndryshme në kundërshtim me piken 4.1 të FDT-së, Pra ky pretendim i OE ankues është i bazuar

Kurse, sa i përket i përket pretendimit të OE ankues “Eing Com” sh.p.k- Podujevë” se OE i rekomanduar nuk ka ofruar katalogë me përshkrim detal për produktet sipas kërkesës së AK-së, Paneli Shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar: Kërkesa 6. Katalogjet për të gjitha pajisjet e ofruara të lodrave dhe të pajisjeve të fitnesit; Dëshmia 6. Katalogjet nga prodhuesi sipas karakteristikave në përshkrim të çmimeve për të gjitha pozicionet e lodrave dhe të pajisjeve të fitnesit. Kurse, OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur katalogun e prodhuesit “AVA Park” sipas kërkesës së AK-së. Andaj, pretendimi ankues është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Lipjan

1x1 OE "EING COM."-Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.